



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 23, Datë 20.01.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “GEGA-G”  
SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 189 prot., datë 17.01.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, brenda afateve të përcaktuara në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit dhe ka depozituar dokumentacion referuar kërkesave të nenit 16 të Rregullores.
- Për sa depozituar nga shoqëria në lidhje me këtë aplikim dhe duke qenë se ajo nuk ka dhënë sqarime në lidhje me dokumentacionin që ka pësuar ndryshime apo modifikime, vlerësohet që t’i kërkohet në vijim në kuadër të informacionit shtesë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtorja e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**